



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 13.01.2023

**NJOFTIM**

**Për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Korçë**

Bazuar në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 11; urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 18, datë 12.01.2023, "Për përzgjedhjen e subjektit/subjekteve që do të licencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë":

Bashkia Korçë njofton zhvillimin e konkursit për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve si më poshtë:

NR.	LINJA	NR. I MJETEVE
1.	Shamoll – Korçë – Shamoll	1 (një)
2.	Dardhë – Korçë – Dardhë	1 (një)
3.	Lekas – Korçë – Lekas	1 (një)
4.	Marjan – Korçë – Marjan	1 (një)
5.	Pulahë – Korçë – Pulahë	1 (një)
6.	Shtyllë – Vithkuq – Shtyllë	1 (një)
7.	Lavdar – Korçë – Lavdar	1 (një)

Subjekti fizik ose juridik duhet të disponojë automjete të përshtatshme për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Korçë dokumentacionin për pjesëmarrjen në konkurs në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

- Kërkesa.
- Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.

- g. Çertifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë se një mjet).
- h. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B.
- i. Leja e qarkullimit (për çdo autobus).
- j. Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus).
- k. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve (për çdo autobus).
- l. Çertifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus).
- m. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus).
- n. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus).
- o. Leja e drejtimit.
- p. Çertifikata e Aftësisë Profesionale.
- q. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij).
- r. Kontrata me agjensinë për transport udhëtarësh brenda vendit.
- s. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Korçë, mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitetet në periudhën e mëparshme).

Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Bashkisë Korçë, deri në datën 27.01.2023.

Kriteret bazë për klasifikimin e subjekteve, në rast se ka më shumë se një aplikant për linjën përkatëse, do të jenë sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 111, datë 11.10.2018.

Klasifikimi bazohet në :

1. Vitin e prodhimit të automjetit.
2. Numrin e viteve që subjekti mund të ketë ushtruar veprimtarinë në transportin e udhëtarëve me autobusë.

Për informacion më të detajuar subjektet e interesuara mund të drejtohen pranë Bashkisë Korçë.